



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESİ

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr.016-126211, të dt. 06.11.2014 me ndryshime dhe plotësime në Statut 01. nr.016-28448 të dt. 22.03.2018, nenit 61 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe nenit 63 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me nenin 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil, Kryetari i Komunës në Cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit civil Vaid Aliu të datës 20.03.2023 i emëruar në pozitën punuese: Zyrtar juridik në DBP për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil – Pensionim i parakohshëm merr:

V E N D I M

P Ë R

**PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS ME LIRIM NGA SHËRBIMIN CIVIL
(Pensionim i Parakohshëm)**

1. Aprovohet kërkesa e datës 20.03.2023 e nëpunësit civil Vaid Aliu me nr. personal të Inj. 1005035801 i lindur më 22.04.1960 e, i emëruar në pozitën punuese: Zyrtar juridik në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari dhe të njëjtit më datë 30.04.2023 i Përfundon Marrëdhënia e Punës në Shërbimin Civil – Pensionim i Parakohshëm 1 vite e 11 muaj e 23 ditë (një vit e njëmbëdhjetë muaj e njëzetëtri ditë) para arritjes së moshës së pensionimit.
2. Nëpunësit civil, të pensionuarit nga pika 1 e këtij vendimi i takon pagesa për pensionim të parakohshëm në lartësi prej 70% e pagës bazë deri në moshën e pensionimit prej gjashtëdhjetëpesë (65) vjeç.
3. Obligohet nëpunësi civil, tani më i pensionuari i parakohshëm nga shërbimi civil që të bënë dorëzimin e detyrës, dokumenteve që lidhen me detyrën punuese, të mjeteve të punës dhe inventarit të mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, Vaid Aliu i emëruar në pozitën punuese: Zyrtar juridik në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari i është drejtuar Njesisë së personelit me kërkesë të datës 20.03.2023 për pensionim të parakohshëm për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore dhe moshës. Njësia e personelit pas pranimit të kërkesës, ka verifikuar të dhënat e nëpunësit civil nga dosja e personelit dhe ka konstatuar se nëpunësi e plotëson moshën e pensionimit të parakohshëm sepse me datë 22.04.2023 mbush moshën gjashtëdhjetëetrevjeqare (63) vjeçare, dhe të njëjtën në afatin e paraparë ligjor ia ka dërguar mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil për shqyrtim dhe dhënie të mendimit.

Pas marrjes së mendimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt i cili ka aprovuar kërkesën e nëpunësit Vaid Aliu, Njësia e personelit, kërkesën e nëpunësit së bashku me mendimin e mbikëqyrësit e ka

dërguar te Udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit-Kryetari i Komunës për aprovim apo refuzim.

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit civil, mendimit të dhënë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil dhe verifikimit të plotësimit të moshës së Pensionimit të parakohshëm nga Njësia e personelit, në bazë të nenit 61 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe nenit 63 paragrafi 1 dhe 3 të LZP Nr.06/L-114 dhe nenit 6 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr.13/2020 për Lirimin dhe Pensionimin e Parakohshëm nga Shërbimi Civil vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla juridike: Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni



Vendimi t'i dërgohet:

- Drejtorit të DBP
- Nëpunësit civil
- Njësisë për personel